



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.29.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
KAMENICËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës në konsultim Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Ekipit - Erëmira Bytyqi-Pllana, si dhe Anëtarët Hysen Boqolli dhe Mexhit Ferati, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
5 Qeverisja e mirë.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	24
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	27
Shtojca III: Letërkonfirmimi	34

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 06/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Kamenicës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne duam të përmendim faktin se pasuritë dhe detyrimet kontingjente nuk ishin shpalosur në mënyrë të drejtë në pasqyrat financiare vjetore.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Kamenicës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin se shpalesjet për regjistrin e pasurive kapitale dhe detyrimeve kontingjente në pasqyra financiare vjetore nuk ishin plotësisht të sakta, për shkak të çështjeve të identifikuara si në vijim:

- Përkundër progresit të bërë në regjistrimin e pasurive, pasuritë kapitale në PFV ishin mbivlerësuar për 29,141€, si rezultat i regjistrimeve të gabuara të mallrave dhe shërbimeve, si dhe subvencioneve, në regjistrin kontabël të pasurive. Kjo çështje ishte theksuar në raportin e vitit paraprak;
- Më pas, vlera e pasurive prej 17,600€, që ishin në proces të ndërtimit (investime në vijim), nuk ishte përfshirë në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1000€, duke bërë që regjistri kontabël i pasurive i shpalesur në PFV të jetë i nënvlerësuar; dhe
- Detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për shumën prej 72,584€, si rezultat i mos harmonizimit të të dhënave të sakta mes zyrës ligjore dhe asaj të financave.

Opinionin jonë nuk është kualifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Kamenicës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Kërkesat e Ligjeve Organike për Qeverisje Lokale;
- Kërkesat e Ligjit të Buxhetit të vitit 2017;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi çështje për të ngritur, përveç atyre të përshkruara tek theksimi i çështjes.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalosjen e pasurive dhe detyrimeve kontingjente dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtaari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Kamenicës kishte shpenzuar 93% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Pavarësisht kësaj, si shkak i mos arkëtimit të mjaftueshëm të të hyrave, kishte pasur ngecje në projekte kapitale dhe vonesa në realizimin e tyre. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në inkasimin e tyre dhe mbledhjen e të të arkëtueshmeve në masë më të madhe. Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtijshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i pagesave, rritja e inkasimit të të hyrave përfshirë menaxhimin e pronave komunale si dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,640,425	8,196,331	7,674,953	7,945,340	7,816,036
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,741,244	6,881,621	6,848,247	7,142,934	6,900,558
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	372,077	243,164	223,232	377,619
Të hyrat vetjake ³	899,181	899,181	549,170	563,011	516,594
Donacionet e brendshme	-	11,068	3,973	-	4,465
Donacionet e jashtme	-	32,384	30,399	16,163	16,800

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 555,906€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 372,077€, donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 43,452€ dhe më pas ndarjen e mjeteve nga Qeveria për shkak të mungesës së buxhetit për paga dhe mëditje në vlerë 70,376€, si dhe për shpenzime komunale në vlerë 70,000€ për shkak të obligimeve të papaguara të vitit paraprak.

Në vitin 2017, Komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final ose 7,674,953€. Megjithatë, në disa kategori, realizimi mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,640,425	8,196,331	7,674,953	7,945,340	7,816,036
Pagat dhe Mëditjet	6,766,498	6,856,801	6,722,121	6,743,433	6,609,654
Mallrat dhe Shërbimet	600,002	672,331	446,286	589,778	506,706
Shërbimet komunale	140,005	248,845	233,519	230,762	160,095
Subvencionet dhe Transferet	9,125	36,730	31,600	100,212	113,121
Investimet Kapitale	124,795	381,624	241,427	281,155	426,460

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për investime kapitale në vlerë 256,829€, ishte si rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 213,886€, si dhe granteve nga donatorët e brendshëm dhe të jashtëm në vlerë 43,452€. Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale, vetëm 63% e buxhetit ishte shpenzuar. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin aktual kishte zvogëlim të shpenzimit për 14%. Realizimi i ulët në këtë kategori rrjedh si pasojë e ngecjeve në realizimin e disa projekteve, vonesave në inicimin e procedurave të prokurimit, si dhe jo efikasitetin në mbledhjen e të hyrave të planifikuara, duke qenë se 87% e investimeve kapitale ishte planifikuar të shpenzohej nga të hyrat;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 90,303€ rezulton fillimisht si shkak i të hyrave të bartura në vlerë 19,926€ dhe më pas shumës prej 70,376€ të ndarë nga Qeveria për shkak të financimit të pagave në fund të vitit. Kjo vinte si rezultat i planifikimit të këtyre shpenzimeve nga të hyrat vetjake dhe më pas ngecjes në mbledhjen e tyre. Në fund, realizimi kundrejt buxhetit ishte 98%;
- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 72,329€. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshinë të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 71,820€ si dhe 509€ të mbetura nga donatorët e jashtëm prej viteve paraprake. Sidoqoftë, realizimi ishte vetëm 66%, për shkak se 88% e kësaj kategorie ka qenë e planifikuar të shpenzohet nga të hyrat, ndërkohë që mos realizimi i mjaftueshëm i të hyrave ka ndikuar në realizim të ulët të kësaj kategorie. Ndërkaq, niveli i detyrimeve të papaguara nga kjo kategori ishte 45,034€;

- Buxheti për komunali ishte rritur për 108,840€. Kjo si rezultat i hyrave të bartura në shumë prej 38,840€, e më pas alokimit të mjeteve nga Qeveria e Kosovës në shumë prej 70,000€, për shkak të obligimeve të papaguara nga viti 2016 prej 38,840€. Realizimi në këtë kategori ishte 94%; dhe
- Subvencionet dhe transferet në buxhetin final ishin rritur për vlerën 27,605€, si rezultat nga të hyrat e bartura. Realizimi krahasuar me buxhetin ishte 86%.

Çështja 2 – Realizimi i buxhetit

E gjetura Komuna nuk kishte arritur të realizoj buxhetin për investime kapitale dhe mallra e shërbime sipas planit dhe projekteve të synuara. Ndonëse në nivel të përgjithshëm, realizimi i buxhetit ishte 93%, në nivel të kategorive si investimet kapitale (63%) dhe mallrat dhe shërbimet (66%), realizimi ishte relativisht i ulët. Kjo kishte ndodhur ngaqë menaxhmenti nuk kishte bërë një planifikim real të të hyrave (një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve për investime kapitale si dhe mallra dhe shërbime ishin planifikuar të mbulohen nga të hyrat vetjake) si dhe nuk kishte bërë analiza në baza të rregullta mbi ecuritë buxhetore.

Gjithashtu, pagesat në vlerë 8,555€, ishin bërë nga investimet kapitale ndonëse sipas natyrës këto shpenzime i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Kjo kishte ndodhur si pasojë e planifikimit dhe buxhetimit jo të drejtë të tyre.

E gjetura Planifikimi jo real dhe realizimi jo i mjaftueshëm në kategoritë përkatëse ndikon në mos arritjen e objektivave të komunës si dhe në bartjen e obligimeve të këtij viti në vitet e ardhshme. Keq-klasifikimi i shpenzimeve shpie në pasqyrim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar shpenzimin e kategorisë së investimeve kapitale kundrejt nën shpenzimit të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Rekomandimi 2 Kryetari të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës të shkaqeve për mos realizim të mirë të kategorive përkatëse, si dhe të sigurojë një planifikim të drejtë buxhetor krahas projekteve të synuara dhe monitorim të performancës buxhetore në baza të rregullta kohore.

3.2 Të hyrat

Gjatë vitit 2017, komuna ka inkasuar të hyra në vlerë 635,564€ apo 71% të buxhetit të planifikuar (899,181€). Kategoritë nga ku janë realizuar të hyrat janë: tatimi në pronë në vlerë 260,373€, taksa për leje ndërtimi, taksa administrative, si dhe të hyra tjera në vlerë 375,191€. Nga tabela më poshtë shohim se fillimisht ka pasur trend të rritjes nga viti 2015 në vitin 2016 në 15%, ndërsa më pas kemi një rënie prej 9% të vitit aktual me vitin paraprak. Kjo rënie ishte si rezultat i mungesës së mekanizmave të mjaftueshëm për inkasimin e të hyrave.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	899,181	899,181	635,564	697,950	604,686
Totali	899,181	899,181	635,564	697,950	604,686

Çështja 3 – Mos-verifikimi i shënimeve ekzistuese lidhur me pronat e tatueshme

- E gjetura** Bazuar në UA 03/2011, neni 13, zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar të bëjë verifikimin e 1/3 të pronave të regjistruara. Nga 10,676 prona të faturuara, komuna kishte verifikuar vetëm 521 prej tyre, apo 4%. Sipas zyrtareve të komunës, mos arritja e verifikimit të 1/3 të pronave, ishte për shkak të numrit të pamjaftueshëm të punonjësve të angazhuar në këtë aktivitet.
- Rreziku** Mos verifikimi i pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale dhe si rezultat nënvlerësimin e të hyrave nga kjo kategori.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj që të merren masa të nevojshme në mënyrë që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 6,856,801€, ndërsa shpenzimet ishin prej 6,722,121€ apo 98% e buxhetit final.

Çështja 4 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit

E gjetura Gjatë vitit 2017, në komunë ishin angazhuar gjithsej 22 punonjës përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Ndonëse sipas ligjit për shërbimin civil, neni 12, për emërimet të tilla, zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit, komuna nuk kishte zbatuar procedura të tilla me rastin e përzgjedhjes së këtyre punonjësve. Gjithashtu, marrëveshjet për shërbime të veçanta kishin të bëjnë me pozita të rregullta dhe jo për punë me kërkesa specifike.

Rreziku Anashkalimi i procedurave të rekrutimit me rastin e lidhjes së kontratave për shërbime të veçanta, rrit rrezikun të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur për kryerjen e shërbimeve të kërkuara. Kjo gjithashtu, nuk siguron trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuar të rekrutimit, përmes konkursit publik dhe vetëm në rast të kërkesave për punë specifike, e jo për pozita të rregullta.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 921,176€. Prej tyre ishin shpenzuar 679,805€ apo 74% e buxhetit final. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me: shpenzime komunale, derivate dhe lëndë për ngrohje, shërbime kontraktuese, shpenzime të udhëtimeve zyrtare si dhe mirëmbajtje dhe riparime.

Çështja 5 - Pagesa e paradhënies për shpenzime komunale

E gjetura Rregulla financiare 01/2013 neni 22, përcakton hapat për procedimin e pagesës, ku fillimisht bëhet pranimi i faturës dhe më pas procedohet pagesa. Në pagesën e testuar për shpenzime të rrymës në vlerë 52,651€, shumën e faturave në total përbente vlerën 48,185€, ndërsa shumën prej 4,466€ nuk ishte e mbështetur me fatura por ishte bërë parapagim i shpenzimeve të parapara. Sipas zyrtarëve financiar, ata kishin parapaguar shpenzime të rrymës me qëllim të shfrytëzimit të mjeteve të ndara në fund të vitit nga Qeveria dhe parashikimeve për vështirësi buxhetore për mbulimin e këtyre shpenzimeve në vitin vijues.

Rreziku Pagesat në avans për shpenzime komunale, në mungesë të faturave por vetëm bazuar në parashikimin e shpenzimeve, mund të rezultojnë në pagesa të parregullta dhe pa mbulim të ligjshëm të tyre.

Rekomandimi 5 Kryetari të siguroj forcimin e kontrolleve me rastin e pagesave, me ç'rast pagesat procedohen vetëm në mbulesë të plotë të faturave dhe verifikimit të saktë të tyre.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 36,729€. Prej tyre, në vitin 2017 ishin shpenzuar 31,600€ apo 86% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndihmë për mirëqenie sociale, ndihmë shëndetësore, aktivitete kulturore si dhe bursa për arsim.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 381,625€. Prej tyre, në 2017 ishin shpenzuar 241,427€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe mirëmbajtjen investive të rrugëve, ndërtesave afariste, rregullimin e kanalizimeve dhe ujësjellësit.

Çështja 6 – Ngecje në realizimin e kontratës me marrëveshje bashkëfinancimi

E gjetura Sipas kontratës, “Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Malësia e re dhe në fshatin Rogoqicë” në vlerë 63,230€, marrëveshje bashkëfinancimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), nënshkruar në shtator 2016 me plan dinamik 80 ditë pune, vlera prej 55,000€ do të financohej nga MMPH, ndërsa pjesa prej 8,230€ nga komuna. MMPH kishte paguar vetëm situacionin e parë në vlerë 31,900€ në vitin 2016, pasi më tutje nuk kishte siguruar mjete për këtë projekt. Më pas, megjithëse komuna si kontraktues kishte obligim mbylljen e kontratës, ky projekt deri në fund të vitit ende nuk ishte realizuar. Përveç tjerash, siguria e ekzekutimit për këtë kontratë kishte skaduar.

Rreziku Ngecja e realizimit të projektit fillimisht si pasojë e mos pagesës së MMPH-së, e më pas mos ndërmarrjes së masave nga komuna, ka ndikuar që ky projekt të tejzgjatet dhe mos të arrihen përfitimet e parapara në favor të qytetarëve. Kjo ndikon edhe në rëndimin e buxheteve për vitet vijuese dhe mundësisë së përballjes së komunës me padi gjyqësore.

Rekomandimi 6 Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë masa konkrete lidhur me realizimin e projekteve të cilat kanë ngecur dhe më tutje, të forcohen kontrollet mbi mbikëqyrjen e projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik.

Çështja 7 - Mungesa e dokumentacionit të plotë për realizimin e projekteve

E gjetura Sipas ligjit të ndërtimit, përkatësisht nenit 14 dhe 29, me rastin e ndërtimeve kërkohet pajisja me dokumentacionin përkatës siç është leja ndërtimore dhe mbikëqyrja inspektive. Në dy projekte, si: “Asfaltime të parkingjeve dhe trotuarëve” dhe “Ujësjellësi Kopernice, Kololeq dhe Shipashnicë” punimet ishin realizuar në mungesë të këtij dokumentacioni.

Rreziku Inicimi i projekteve në mungesë të kompletimit të dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit për ndërtim, mund të ndikojë në cilësinë dhe ngecjen në realizimin e këtyre projekteve.

Rekomandimi 7 Kryetari të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e ligjit të ndërtimit, me ç'rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit të sigurohet leja e përdorimit.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna kishte regjistruar pasuritë komunale sipas rekomandimit të dhënë, megjithatë ende janë evidentuar mangësi në regjistrin kontabël të pasurive, çështje kjo të cilën e kemi trajtuar tek Kapitulli i Opinionit të Auditimit – Theksimi i çështjes. Përveç kësaj, janë hasur edhe mangësi tjera të prezantuara në vijim.

Çështja 8 - Inventarizimi dhe mos harmonizimi me regjistrat e pasurisë

- E gjetura** Sipas rregullores 02/2013 mbi pasurinë jo-financiare, neni 18, inventarizimi i pasurisë bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Komisioni kishte bërë inventarizimin e pasurisë, mirëpo ky raport nuk është krahasuar me regjistrat e pasurisë për të identifikuar diferencat. Për më tepër, komisioni kishte kryer inventarizimin vetëm për pasurinë nën 1,000€, duke mos përfshirë inventarizimin e tërë pasurisë së komunës, përfshirë edhe atë mbi 1,000€.
- Rreziku** Mos inventarizimi i plotë i pasurisë, shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive.
- Rekomandimi 8** Kryetari të siguroj se procesi i inventarizimit përfshinë gjithë pasurinë komunale dhe pas kryerjes së këtij procesi, gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

3.8 Të arkëtueshmet

Në fund të vitit 2017, llogaritë e arkëtueshme (LLA) ishin 2,018,490€ ku prej tyre pjesëmarrja ishte si në vijim: Tatimi në pronë në vlerë 1,381,980€; Taksa komunale në vlerë 465,840€; Taksa për leje ndërtimi 67,650€; Shfrytëzimi i hapësirës publike në vlerë 91,000€, si dhe Qiraja në vlerë 12,020€. Vlera totale e LL/A paraqet një vlerë mjaft të lartë marrë parasysh planifikimin e të hyrave për vetëm 899,181€ dhe realizimin prej 635,564€

Çështja 9 – Mungesa e mekanizmave për mbledhjen e të arkëtueshmeve

- E gjetura** Komuna nuk kishte ndërmarrë masa aktive për inkasimin e llogarive të arkëtueshme, duke bërë që ato të pësonin rritje për 358,270€ apo 22% në krahasim me vitin e kaluar (1,660,220€). Rritjet kanë rezultuar në pothuajse të gjitha kategoritë e LLA-ve. Kjo për shkak të mungesës së vendosjes së mekanizmave nga komuna për rritjen e arkëtimit të tyre.

Rreziku Mos aplikimi i masave konkrete lidhur me inkasimin e LLA-ve, ka ndikuar në rritjen e tyre dhe njëkohësisht në mos realizimin e shpenzimeve të cilat ishin planifikuar të financoheshin nga të hyrat.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të rishqyrtojë shkaqet për dështimin në inkasimin e LLA-ve dhe të siguroj se janë vendosur mekanizma efektiv për mbledhjen e të tyre. Kryetari po ashtu duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave ligjore për mbledhjen e tyre.

Çështja 10 - Mos shpallja e ankandit për shfrytëzimin e pronave komunale

E gjetura Sipas Ligjit 04L/144, neni 5, dhënia e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim bëhet përmes një konkursi të hapur publik në formë të ankandit. Komuna nuk kishte realizuar shpallje publike për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të kiosqeve, apo pronave të tjera në pronën publike gjatë vitit 2017. Rrjedhimisht, si pasojë e mos-ligjshmërisë së shfrytëzimit të këtyre pronave, komuna nuk kishte faturuar ato, duke mos realizuar të hyrat e mundshme nga shfrytëzimi i këtyre pronave.

Rreziku Mos aplikimi i masave për dhënien në shfrytëzim të ligjshëm të këtyre pronave, ndikon në nënvlerësimin e arkëtimeve nga shfrytëzimi i hapsirës publike.

Rekomandimi 10 Kryetari të siguroj ndërmarrjen e masave për shpalljen publike të dhënies në shfrytëzim të kiosqeve dhe pronave tjera komunale, në mënyrë që më pas të bëhet faturimi i rregullt i tyre.

3.9 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 55,322€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Krahasuar me vitin paraprak ku vlera e obligimeve të papaguara ishte 76,807€, në fund të këtij viti ato kishin ishin zvogëluar për 28%. Kjo për shkak se Qeveria në fund të vitit kishte mbuluar obligimet nga viti paraprak.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të komunës së Kamenicës ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Por, ky plan veprimi nuk ka pasuar më tutje me hapa konkret dhe opsione praktike për adresimin e këtyre rekomandimeve nga personat përgjegjës.

Deri në fund të auditimit tonë, nga 13 rekomandimet e dhëna për vitin 2016, vetëm një ishte zbatuar; tetë ishin në proces, ndërsa katër nuk ishin zbatuar. Po ashtu, nga viti 2015 nga 13 rekomandime të bartura, një ishte zbatuar gjatë vitit 2017, 10 ishin në proces ndërsa dy nuk ishin zbatuar. Për një përshtetje më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 11 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Mungesa e një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, ka ndikuar që një numër i vogël i rekomandimeve të janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë në proces të zbatimit, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me zbatimin e tyre, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuara në komunë.

Moszbatimi i rekomandimeve në vazhdimësi, tregon se kontrollet e menaxhmentit dhe sistemeve tjera financiare nuk kanë funksionuar mjaftueshëm dhe kjo ka rezultuar në:

- Shpalosjet jo të sakta të pasurive dhe detyrimeve kontingjente në pasqyra financiare;
- Vonesa në realizimin e projekteve dhe keq-klasifikim të shpenzimeve; dhe
- Menaxhim jo i mirë i të arkëtueshmeve dhe pronave komunale.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimit të rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë, ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, zhvillimi mbi proceset e menaxhimit të rrezikut, menaxhimi i projekteve kapitale dhe pasurisë komunale, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Si pjesë të planeve strategjike, komuna posedon Planin Zhvillimor Komunal 2013-2023 dhe Planin Zhvillimor Urban 2013-2018, por nuk ka një plan strategjik për përcaktimin e afateve për arritjen e objektivave dhe monitorimin e tyre, duke llogaritur kosto për zbatimin e tij. Gjithashtu, ndonëse ishte planifikuar, projekti për hartimin e hartës zonale nuk ishte inicuar gjatë vitit 2017.

Komuna kishte arritur të përmbushë kërkesën e MF-së për dorëzimin e pyetësorit të vetvlerësimit, megjithatë në aspektin e menaxhimit të rrezikut, komuna ende nuk ka arritur të përgatisë listën e rreziqeve përmes së cilës do të identifikoheshin pika të rëndësishme të rreziqeve me të cilat përballen departamentet përkatëse dhe reagimet ndaj rreziqeve të identifikuara.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më detajisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Komiteti i Auditimit (KA) ka qenë funksional dhe ka mbajtur takime, megjithatë nevojitet një punë më cilësore dhe përpjekje më e lartë e këtij komiteti për të shtyrë menaxhmentin që të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i jashtëm dhe ai i brendshëm.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - drejtori i NjAB-së dhe një auditor. NjAB-i kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës, ku kishte planifikuar kryerjen e 10 auditimeve. Ne kemi marrë në konsideratë punën e auditorëve të brendshëm, veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë në adresimin e rekomandimeve si dhe angazhimet KA-së. Ne kemi vlerësuar se NjAB-i kishte arritur të realizoj suksesshëm planin e saj duke përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara, megjithatë përmirësime të mëtutjeshme nevojiten për një funksionim më të dobishëm në këtë fushë.

Çështja 12 - Mos zbatueshmëria e rekomandimeve të auditimit të brendshëm

E gjetura Nga gjithsej 27 rekomandime të dhëna, vetëm 10 ishin zbatuar plotësisht, 11 ishin në proces të zbatimit ndërsa gjashtë kanë mbetur të pazbatuara. Periudha të cilën e mbulonin rekomandimet e dhëna, me theks të veçantë për fushën e prokurimit, kryesisht kishte të bëjë me vitin paraprak. Moszbatimi i rekomandimeve të dhëna, tregon një mungesë të vullnetit të menaxhmentit për marrjen e përfitimeve nga auditimi i brendshëm dhe sigurisë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mosaplikimi i një plani bazuar në rrezik ndikon në mosidentifikimin e dobësive aktuale duke rezultuar me joefikasitet në dhënien e sigurisë ndaj menaxhmentit lidhur me funksionimin e kontrolleve të brendshme. Njëherit, moszbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti redukton efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identifikuar.

Rekomandimi 12 Kryetari të siguroj se, plani i NjAB-së të zbatojë një qasje ndaj fushave me rrezik duke ndihmuar aktivitetet operative në vazhdim, si dhe një fokus më të lartë të menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve, në mënyrë që përfitimet nga auditimi i brendshëm të jenë sa më të larta.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguuar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk janë mjaft efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja 13 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut**E gjetura**

Si pasojë e mos vendosjes së mekanizmave adekuat për inkasimin e të hyrave, kishte pasur ngecje në realizimin e projekteve kapitale si dhe rritje të obligimeve ndaj furnitorëve. Kjo më pas ishte zgjidhur me vendim të Qeverisë për bartjen e mjeteve për të financuar këto obligime. Më tutje, mos inicimi i procedurave të prokurimit, vonesat në projekte, pagesat në formë të paradhënies pa mbështetje të faturave, nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Ende kishte mangësi në fushën e menaxhimit të pasurisë, me ç'rast inventarizimi nuk kishte përfshirë gjithë pasurinë komunale si dhe nuk ishte bërë krahasimi me regjistra të pasurisë. Poashtu, regjistrat ende nuk ishin të saktë si rezultat i mos regjistrimeve dhe regjistrimeve të gabuara.

Menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, si dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative. Gjithashtu, Komuna nuk posedon regjistër të rreziqeve të hartuar sipas kërkesave të MFK-së, për t'i identifikuar rreziqet në nivel të departamenteve dhe marrjen e masave për menaxhimin e tyre.

Rreziku

Kërkesat e pamjaftueshme të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë jo të mirë reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 13

Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, si dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, komuna duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rrezikun domethënës për pasuritë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.		Ndonëse ka pasur përmirësime gjatë viteve, ende ka mangësi tek shpalosjet e PF-ve.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Komuna ka hartuar planin e veprimit, megjithatë nuk janë ndërmarrë masa rigoroze që do të përcaktonin qartë adresimin e rekomandimeve, me ç`rast ka ndikuar që disa nga këto rekomandime të përsëriten.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Gjithashtu, sa i përket objektivave strategjike komunale, Kryetari duhet të caktojë ekip përgjegjës i cili harton planin e veprimit për rekomandimet e zbatueshme. Dokumentet e tilla nuk duhet të mbesin vetëm të shkuara në letër.		Ende mungojnë dokumentacione mbështetëse, të plotësimit të listës kontrolluese të vetëvlerësimit.	

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk janë marrë masa
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimitarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.		Ekzistojnë raportet tremujore, gjashtë mujore dhe vjetore nga drejtorja e financave, megjithatë nuk ka raportime formale nga të gjitha drejtoritë mbi aktivitetet operative në baza të rregullta kohore.	
3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku mund të bëhen përshtatjet për reduktim të shpenzimeve operative, të njëjtat të rishikohen për koncentrim në projekte kapitale.		Performanca buxhetore nuk është monitoruar mjaftueshëm, duke ndikuar që në kategorinë e investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve të mos ketë shpenzim të kënaqshëm.	
3.5.1 Shpenzime tjera	Kryetari duhet të sigurojë se kontratat për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, planifikohen drejtë dhe bëhen në pajtim me ligjin. Ne sugjerojmë që kjo praktikë të ndërpritet sa më parë.		Vazhdojnë të rekrutohen punonjës me kontratë për shërbime të veçanta për pozita të rregullta dhe pa konkurs.	
	Kryetari duhet të rishikoj rastet e mësipërme dhe të merr masat e duhura. Gjithashtu, duhet të sigurojë se zyrtarët respektojnë në tërësi kërkesat e rregullores së brendshme për përdorimin e veturave zyrtare. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se automjetet zyrtare përdoren vetëm nga personat e autorizuar dhe me fletudhëtime të plotësuara dhe të aprovuara nga menaxhmenti i komunës.		Plotësohen fletudhëtimet megjithatë ende mungon raportimi i rregullt në njësinë e transportit lidhur me përdorimin e veturave zyrtare.	

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të sigurojë se procedura efektive zbatohen me rastin e dhënies së subvencioneve si dhe respektohen kriteret e rregullores. Sa i përket subvencioneve për arsimin jo formal, të ushtrohet mbikëqyrje e vazhdueshme për t'u siguruar se mjetet derdhen në llogarinë e buxhetit komunal. Gjithashtu, të bëhet monitorim i vazhdueshëm i shpenzimeve të subvencioneve në mënyrë që të sigurohen raporte të vlefshme për arsyeshmërinë e shpenzimeve.	Po		
3.6 Të hyrat	Kryetari duhet të mbikëqyrë në mënyrë të veçantë procesin e të gjitha qiradhëniesve komunale, me theks të veçantë në nevojën për mbështetje me bazë kontraktuale të çdo prone të lëshuar me qira. Komuna duhet të jetë më rigorozë në mbledhjen e borxheve nga qiraja, ndërsa obliguesve që nuk kanë paguar qiratë, t'u ndërpritet mundësia e shfrytëzimit të mëtejshëm të pronave.		Vazhdon shfrytëzimi i pronave në mungesë të kontratave dhe shpalljeve publike.	
3.6 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, të verifikohet legjitimiteti i faturimit të objekteve në regjistrin e tatimit në pronë dhe të dhënat të azhurnohen sipas kërkesave ligjore mbi pronën e paluajtshme. Më tej, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzoj të gjitha burimet për verifikim të pronave.			Nuk janë marrë masa

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të formoj komisione për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e regjistrimit duhet të integrohen në një regjistër të vetëm për të gjithë sektorët. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.		Komisionet janë formuar në mënyrë të rregullt megjithatë ka pasur mangësi në procesin e inventarizimit.	
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshëm duke i trajtuar të gjitha në mënyrë të veçantë, në Kuvendin Komunal.		Mungojnë mekanizma për inkasimin e të arkëtueshmeve.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinionit si dhe të ndërmerren veprime për përmirësimin dhe mos përsëritjen e tyre në të ardhmen. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		Ndonëse një pjesë e rekomandimeve për regjistrimin e pasurive ishte zbatuar, ende kishte mangësi tek shpalosjet në PF.	

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të aplikoj masa përgjegjësie ndaj personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve dhe sigurojë se plani i veprimit po zbatohet me kohë dhe në mënyrë efektive për të gjitha rekomandimet e dhëna, dhe me fokus të veçantë tek ato me prioritet të lartë. Progresi në zbatimin e rekomandimeve duhet t'i nënshtrohet rishikimeve sistematike nga Kryetari.		Është hartuar plani i veprimit megjithatë nuk ka dëshmi të dhënies së prioriteteve zbatimit të rekomandimeve, me fokus atyre me prioritet te larte. Njëkohësisht nuk ka dëshmi të rishikimit të zbatimit të tyre nga Kryetari.	
2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar strategjia zhvillimore gjithëpërfshirëse duke përfshirë palët e interesit dhe duke llogaritur kostot për implementimin e saj, si dhe të bëhet vlerësimi i rreziqeve me të cilat mund të ballafaqohet komuna.		Pyetësori i vet-vlerësimit është plotësuar, mirëpo nuk është përpiluar lista e rreziqeve në nivel të departamenteve.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të miratoj një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbejë si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.			Nuk janë marrë masa
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme gjatë muajve në vijim.		Përveç raporteve të cilat në baza të rregullta përgatiten për kuvendin komunal, ende mungon përcaktimi i një forme të raportimit formal të drejtorive mbi aktivitetet financiare dhe operative tek Kryetari. Ndonëse mbahen takime, mungojnë procesverbalet për takimet e mbajtura.	

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me implementimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.		Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i brendshëm nuk është i kënaqshëm.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson shkaqet dhe barrierat për mos zbatim me kohë të investimeve kapitale dhe për bartjen e vazhdueshme të obligimeve në buxhetet e viteve vijuese.			Nuk janë marrë masa
3.1.1 Të hyrat	Për të shmangur ndikimet e përmendura më lart, Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit vjetor të pronave dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale, bëhet në baza të rregullta vjetore, dhe sipas kuotave të përcaktuara me Udhëzimet administrative.		Janë verifikuar 541 prona apo 4% e pronave, ndërsa nuk është arritur verifikimi i 1/3 së pronave.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që mekanizmat e duhur për mbledhjen e borxheve operojnë dhe duhet të sigurohet që të aplikohen gjobat në vonesat e caktuara dhe njëkohësisht të sigurohet transparencë, dhe trajtim i drejtë dhe i barabartë për të gjithë shfrytëzuesit e mundshëm gjatë dhënies së hapësirave me qira.			Nuk janë marrë masa
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, dhe mbajtja e tatimeve në burim të jetë në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.		Mbajtja e tatimit është aplikuar, megjithatë edhe gjatë 2017 përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, dhe në mungesë të konkurseve, janë angazhuar punonjës që kanë mbuluar pozita të rregullta.	

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha kontratat e nënshkruara përmbajnë afate të qarta kohore të cilat përcaktojnë periudhën kohore brenda të cilës kontratat duhet të përfundojnë.	Po		
3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet regjistrohen në kategorinë e duhur, duke siguruar pasqyrim të saktë të shpenzimeve për të gjitha kategoritë.		Ka pasur raste të keq klasifikimeve tek investimet kapitale.	
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që komisioni i inventarizimit vjetor të pasurisë jo financiare, të bëjë inventarizimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe të bëjë krahasimin e saj më gjendjen në regjistrat kontabël. Diferencat e që dalin si rezultat i regjistrimeve, duhet të sqarohen me menaxhmentin dhe regjistrat përfundimtar, të prezantojnë gjendjen aktuale të pasurisë.			Nuk janë marrë masa

Shtojca III: Letërkonfirmimi

	<p style="font-size: small;">REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBSIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA</p> <p>Sh. U. <u>02</u> Nr. Br. <u>15246</u></p> <p>Nr. i faq. <u>01</u> Data: <u>18.05</u> Datum: <u>2018</u></p>		
Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo	KAMENICËJA	Komuna e Kamenicës Opstina Kamenica Kamenica Municipality	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Kamenicës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



z. Qëndron Kastrati

Kryetar i Komunës,

Data: 17.Maj.2018, Kamenicë,